



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 31

2003

Maj

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr.9049
datë 10.4.2003

Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve
financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë.. 1005

Ligj nr.9053
datë 17.4.2003

Për disa shtesa në ligjin nr.7973, datë 26.7.1995 "Për
koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet
publike dhe infrastrukturë", i ndryshuar..... 1016

L I G J
Nr.9049, datë 10.4.2003

**PËR DEKLARIMIN DHE KONTROLLIN E PASURIVE, TË DETYRIMEVE FINANCIARE TË
TË ZGJEDHURVE DHE TË DISA NËPUNËSVE PUBLIKË**

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

K R E U I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i rregullave për deklarimin dhe kontrollin e pasurisë, të legjitimitetit të burimeve të krijimit të saj, detyrimeve financiare për të zgjedhurit, nëpunësit publikë, për familjarët e tyre dhe për personat e lidhur me ta.

Neni 2

Përkufizime

Përveçse kur përcaktohet ndryshe, në ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Aksion" është titull pronësie, që përfaqëson njërën nga pjesët në të cilat është ndarë kapitali i një shoqërie dhe që i jep të drejtën zotëruesit të saj të marrë pjesë në fitime.
2. "Likuiditete" janë mjetet monetare, të vendosura në cash, llogari rrjedhëse, depozita, me dhe pa afat, bono thesari, obligacione dhe huadhënie.
3. "Pasuri e luajtshme e regjistruar" është çdo pasuri që nuk përfshihet në pasuritë e paluajtshme, e detyrueshme për t'u regjistruar në regjistrat publikë.
4. "Persona të lidhur" janë të gjithë personat, fizikë ose juridikë, të cilët, nga kërkimet administrative, rezultojnë të kenë pasur ose të kenë lidhje pasurore me personin që mbart detyrimin për deklarim, në njërën nga format e përcaktuara në këtë ligj.
5. "Pjesë e kapitalit" është pjesa që zotëron një ortak në kapitalin e shoqërisë.
6. "Transanksion" është veprimi me anë të të cilit sigurohet kalimi i të drejtave dhe detyrimeve pronësore nga njëri pronar tek tjetri.

Neni 3

Subjektet që mbartin detyrimin për deklarim

1. Mbartin detyrimin për deklarim në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive:

a) Presidenti i Republikës, deputetët e Kuvendit, Kryeministri, Zëvendëskryeministri, ministrat e zëvendësministrat;

b) nëpunësit civilë të nivelit të lartë dhe të mesëm drejtues, sipas përcaktimit të nenit 11 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil" ;

c) prefektët, kryetarët e këshillave të qarqeve, kryetarët e bashkive, të njësive bashkiake dhe të komunave;

ç) drejtorët e drejtorive dhe komandantët e Forcave të Armatosura në Ministrinë e Mbrojtjes dhe në Shërbimin Informativ Shtetëror;

d) prokurorët, gjyqtarët dhe përmbaruesit e të gjitha niveleve;

dh) drejtuesit e institucioneve të pavarura publike;

e) drejtorët e përgjithshëm, drejtorët e drejtorive dhe shefat e sektorëve, (komisariateve) në qendër, rrethe e rajone, të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe asaj të Doganave;

ë) anëtarët e inspektoratit të ulët të deklarimit dhe kontrollit të pasurisë;

f) drejtuesit e të gjitha niveleve të strukturave të kthimit e kompensimit të pronave, të privatizimit dhe regjistrimit të pasurisë;

g) drejtuesit e të gjitha niveleve të KRRT-ve;

gj) zyrtarët që zgjidhen dhe emërohen nga Kuvendi, Presidenti i Republikës, Kryeministri, ministrat ose personat e barazuar me ta;

h) drejtuesit e shoqërive anonime me pjesëmarrje të kapitalit shtetëror mbi 50 për qind dhe mesatarisht me më shumë se 50 punëtorë.

Martin detyrimin për deklarim të pasurisë në inspektoratin e ulët:

Subjektet që përcaktohen nga titullarët e ministrive dhe të institucioneve qendrore, sipas paragrafit të parë të nenit 18 të këtij ligji, duke përfshirë detyrimisht:

a) autoritetet që urdhërojnë dhe autorizojnë përdorimin e fondeve publike dhe që i prokurojnë ato;

b) personat që ngarkohen me mbledhjen dhe vjeljen e të ardhurave të buxhetit, qendror e vendor;

c) nëpunësit publikë që mbikëqyrin përdorimin e fondeve publike dhe ata që, sipas ligjit, shqyrtojnë dhe japin licenca.

Kuvendi, me propozimin e Inspektorit të Përgjithshëm, vendos detyrimin për deklarim të pasurisë për funksione të tjera të paparashikuara në këtë ligj.

Neni 4

Afati dhe objekti i deklarimit

Subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe në inspektoratet e ulëta, brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të pasurive, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare si më poshtë:

a) pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to;

b) pasuritë e luajtshme, të regjistrueshme në regjistrat publikë;

c) sendet me vlerë të veçantë mbi 5 000 dollarë amerikanë;

ç) vlerën e aksioneve, të letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim;

d) vlerën e likuiditeteve, gjendje në cash, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj;

dh) detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë, të shprehura në lekë ose në valutë të huaj;

e) të ardhurat personale për vitin, nga paga ose pjesëmarrja në borde, komisione ose çdo veprimtari tjetër që sjell të ardhura personale;

ë) licencat dhe patentat që sjellin të ardhura.

Neni 5

Refuzimi për deklarim

1. Refuzimi për deklarim sjell humbjen e funksionit dhe ndëshkimin në përputhje me Kodin Penal. Inspektori i Përgjithshëm, brenda 30 ditëve, i dërgon organit përgjegjës njoftimin e motivuar për

largimin nga puna të personit që refuzon të deklarojë.

Organi përgjegjës, brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit, është i detyruar të marrë masa për largimin nga puna të punonjësit që ka refuzuar deklarin.

2. Kur deklarimi refuzohet nga personat e zgjedhur ose nga ata me imunitet, Inspektori i Përgjithshëm vë në dijeni Kuvendin dhe, kur është rasti, edhe organin epror të personit.

Në të gjitha rastet e refuzimit të deklarimit, me kalimin e 30 ditëve nga njoftimi i organit përgjegjës, Inspektori i Përgjithshëm detyrohet t'i bëjë publike rastet e refuzimit të deklarimit.

Neni 6

Deklarimi i parë

Të gjitha subjektet e përcaktuara në nenin 3, që mbartin detyrimin për deklarin, në çastin e hyrjes në fuqi të këtij ligji detyrohen të deklarojnë të gjitha pasuritë e akumuluar, detyrimet financiare dhe burimet e origjinës të tyre.

Neni 7

Deklarimi me kërkesë

Inspektori i Përgjithshëm ka të drejtë të kërkojë deklarimin e pasurive dhe burimet e krijimit të tyre, sipas kërkesave të këtij ligji, si dhe të urdhërojë kontrollin për saktësinë e këtyre deklarimeve edhe për personat fizikë e juridikë, kur, nga verifikimet e kryera, rezulton se këta të fundit janë persona të lidhur me subjektet që mbartin detyrimin për deklarin.

Neni 8

Deklarimi pas largimit nga funksioni

Subjektet, për të cilat është parashikuar detyrimi për deklarin, detyrohen të deklarojnë edhe për një periudhë prej dy vjetësh pas largimit nga funksioni. Presidenti, Kryeministri, ministrat, deputetët, zëvendësministrit, sekretarët e përgjithshëm, gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe të të gjitha niveleve të gjyqësorit, prokurorët, drejtorët e përgjithshëm të institucioneve qendrore, do ta kenë këtë detyrim për një periudhë prej katër vjetësh pas largimit nga funksioni.

Neni 9

Deklarimi para fillimit të punës

Punonjësit që fillojnë punë për herë të parë në njërin nga funksionet, që mbartin detyrimin për deklarin, janë të detyruar të deklarojnë, sipas kërkesave të nenit 6 të këtij ligji.

Neni 10

Autorizimi i kontrollit

Deklarimi i pasurisë shoqërohet me një autorizim të veçantë, ku deklaruesi autorizon organet e përcaktuara në këtë ligj të verifikojnë të gjitha subjektet, private e publike, brenda dhe jashtë vendit, për të dhënat e deklaratës.

Mosdhënia e këtij autorizimi, brenda 15 ditëve nga mbarimi i afatit për deklarin, sjell ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, sipas procedurave të përcaktuara në legjislacionin që rregullon marrëdhëniet e punës.

KREU II

ORGANET, KOMPETENCAT DHE STRUKTURA

Neni 11

Inspektori i Përgjithshëm

1. Organi përgjegjës për kontrollin e deklarimit të pasurive është Inspektori i Përgjithshëm.
2. Inspektori i Përgjithshëm zgjidhet nga Kuvendi, me propozimin e Presidentit, ndërmjet dy kandidaturave, për një mandat 5-vjeçar.
3. Inspektori i Përgjithshëm gëzon pagën dhe përfitimet e anëtarit të Gjykatës së Lartë.
4. Inspektori i Përgjithshëm bën deklarimin e parë të pasurisë brenda 30 ditëve nga zgjedhja e tij dhe çdo vit, sipas nenit 4 të këtij ligji, pranë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 12

Kushtet për t'u zgjedhur

Inspektor i Përgjithshëm mund të zgjidhet kandidati që plotëson kushtet e mëposhtme:

- a) të jetë shtetas shqiptar;
- b) të ketë arsimin e lartë, si ekonomist financiar ose jurist;
- c) të ketë vjetërsi pune në profesion jo më pak se 10 vjet dhe moshë mbi 35 vjeç;
- ç) të mos jetë i dënuar për vepra penale;
- d) të mos jetë larguar nga puna ose nga shërbimi civil me masë disiplinore.

Neni 13

Papajtueshmëritë

Funksioni i Inspektorit të Përgjithshëm është i papajtueshëm me:

- a) çdo funksion tjetër publik;
- b) çdo veprimtari tjetër fitimprurëse, me përjashtim të mësimdhënies;
- c) anëtarësimin në partitë politike dhe pjesëmarrjen në veprimtaritë e tyre.

Neni 14

Mbarimi i mandatit

1. Mandati i Inspektorit të Përgjithshëm mbaron kur:
 - a) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi;
 - b) nuk paraqitet në detyrë për më shumë se 3 muaj;
 - c) jep dorëheqjen;
 - ç) me vendim gjyqësor të formës së prerë deklarohet i paaftë për të vepruar.
2. Inspektori i Përgjithshëm mund të shkarkohet nga Kuvendi me kërkesë të jo më pak se 1/3 të të gjithë anëtarëve:
 - për shkelje të dispozitave të këtij ligji;
 - kur kryen veprimtari që krijon konflikt interesash;
 - kur zbulohen raste të papajtueshmërisë së funksionit të tij.
3. Në rast se vendi i Inspektorit të Përgjithshëm mbetet vakant, Presidenti i Republikës, brenda 15 ditëve, i propozon Kuvendit dy kandidatura për Inspektor të Përgjithshëm. Kuvendi zgjedh Inspektorin e Përgjithshëm brenda 15 ditëve nga paraqitja e kandidaturave.

Neni 15

Kompetencat e Inspektorit të Përgjithshëm

Inspektori i Përgjithshëm ka këto kompetenca:

- a) drejton Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, për të kontrolluar deklarimin dhe legjitimitetin e burimeve të pasurive të deklaruar nga subjektet e parashikuara nga ky ligj

në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë;

b) njofton, rast pas rasti, Presidentin, Kuvendin, Këshillin e Lartë të Drejtësisë, Këshillin e Ministrave, Kryeministrin, ministrat dhe drejtuesit e institucioneve qendrore për parregullsitë e vërtetuara në deklarin e pasurisë nga punonjësit në juridiksionin e tyre.

Neni 16

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, struktura dhe buxheti

1. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, që më poshtë do të quhet "Inspektorati i Lartë", është person juridik publik, i cili, nën përgjegjësinë e Inspektorit të Përgjithshëm, administron deklarin e pasurisë, të detyrimeve financiare dhe kontrollin e këtij deklarimi, sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj.

2. Struktura organizative e Inspektoratit të Lartë caktohet nga Inspektori i Përgjithshëm.

3. Inspektorët e Inspektoratit të Lartë gëzojnë statusin e nëpunësit civil.

4. Inspektorati i Lartë ka buxhetin e vet të pavarur, të caktuar nga Kuvendi, i cili vendos numrin dhe pagat e punonjësve të këtij Inspektorati.

Neni 17

Kompetencat e Inspektoratit të Lartë

Inspektorati i Lartë ka këto kompetenca:

- a) ushtron kontrollin e drejtpërdrejtë të deklarimeve në emërtesë të tij;
- b) mbledh të dhëna, kryen hetime dhe kërkime administrative rreth deklarimeve të personave që kanë detyrimin për deklarim, sipas këtij ligji, në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative;
- c) ushtron kontroll për deklarimet e bëra edhe për subjektet e përcaktuara si emërtesë e inspektoratit të ulët;
- ç) bashkëpunon me organet e auditimit dhe me strukturat e tjera përgjegjëse për luftën kundër korrupsionit dhe krimit ekonomik;
- d) mbikëqyr funksionimin e inspektoratit të ulët.

Neni 18

Inspektoratet e ulëta

Të gjitha institucionet e administratës publike të nivelit qendror dhe vendor, institucionet e pavarura, organet e pushtetit vendor, prefekturat, bankat dhe institucionet financiare e shoqërore, korporatat e shndërruara ose jo në shoqëri anonime, ku pjesëmarrja e shtetit është mbi 50 për qind, janë të detyruara të ngrenë inspektoratin e ulët të kontrollit të deklarimit të pasurive, që më poshtë do të quhet "Inspektorati i ulët". Përfshihen nga ky rregull bashkitë dhe komunat që, sipas përcaktimit të Inspektorit të Përgjithshëm, deklarimi i pasurisë së punonjësve të tyre do të bëhet pranë inspektoratit të ulët të qarkut.

Inspektorati i ulët caktohet me urdhër të titullarit të subjekteve të përcaktuara në paragrafin e parë të këtij neni.

Neni 19

Kompetencat e inspektoratit të ulët

Inspektorati i ulët ka këto kompetenca:

- a) organizon dhe kryen kontrollin e deklarimit të pasurive të emërtesës së caktuar dhe i raporton titullarit të ministrisë ose institucionit qendror rezultatet e kontrollit, sipas afateve të caktuara prej tij, duke paraqitur edhe propozimet përkatëse për shkeljet dhe parregullsitë, në përputhje me ligjin nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil" dhe Kodin e Punës;

b) mbledh dhe i dërgon Inspektoratit të Lartë të gjitha deklaratimet që janë emërtesë e tij, si dhe e njofton atë periodikisht për mosdeklarimet, parregullsitë dhe kundërvajtjet e zbuluara nga kontrolli i kryer.

Neni 20

Përbërja e inspektoratit të ulët

1. Inspektorati i ulët përbëhet nga 3 deri në 5 veta, ku kryetar është drejtori i personelit dhe anëtarë njëri nga specialistët e zhvillimit të burimeve njerëzore dhe nëpunës të tjerë me profesion ekonomistë ose juristë.

2. Për ushtrimin e funksioneve, anëtarët e inspektoratit të ulët përfitojnë një shtesë mbi pagën mujore prej 15 për qind.

KREU III

ORGANIZIMI I DEKLARIMIT DHE KONTROLLI

Neni 21

Deklarimi

Deklarimi i pasurive, i burimeve të tyre, i detyrimeve financiare bëhet sipas kërkesave të përcaktuara në këtë ligj dhe në formën e përcaktuar nga Inspektori i Përgjithshëm. Deklarimi përfshin pasurinë e subjektit dhe të familjes së tij (bashkëshortit/es dhe fëmijëve në moshë madhore), burimet e krijimit dhe detyrimet financiare të subjektit.

Deklarimi duhet të përmbajë edhe faktin nëse deklaruesi/sja ka ose jo persona të tjerë të lidhur. Deklaruesit, përpara deklaratës, duhet t'i jepen të gjitha këshillimet e nevojshme për plotësimin e deklaratës dhe t'i bëhen të njohura rrjedhimet që mbart deklarimi i rremë.

Neni 22

Deklarimi i pjesëtarëve të familjes

Kur pasuria e pjesëtarëve të familjes është e ndarë dhe e regjistruar si e tillë në organet e administratës shtetërore ose gjyqësore, deklarimi paraqitet veçmas nga çdo anëtar i familjes, me pasuri të regjistruar në emër të vet dhe i bashkëlidhet deklaratës së personit që ka detyrimin për deklarim.

Neni 23

Paraqitja e deklaratimit dhe afatet

Të gjitha subjektet që mbartin detyrimin për deklarim, sipas këtij ligji, detyrohen ta paraqesin deklaratën e tyre të mbyllur në zarf në inspektoratin e ulët brenda afateve të përcaktuara në këtë ligj.

Brenda 15 ditëve nga kalimi i afatit të paraqitjes së deklaratave, inspektorati i ulët bën përzgjedhjen e tyre, sipas përcaktimeve të nenit 3 të këtij ligji, dhe i përcjell Inspektoratit të Lartë deklaratat në emërtesë të këtij të fundit, si dhe listën e personave që nuk kanë deklaruar, në qoftë se ka të tillë.

Neni 24

Përpunimi paraprak

Inspektorati i Lartë dhe ai i ulët bëjnë përpunimin paraprak të deklaratimeve, i cili përfshin juridiksionin, rregullsinë e plotësimit të deklaratës dhe të anekseve, dokumentet justifikuese dhe ligjshmërinë e tyre.

Kur nga përpunimi paraprak vërtetohen gabime materiale ose plotësime të gabuara, Inspektorati njofton subjektin që ka paraqitur këto deklarime, i cili, brenda 15 ditëve nga marrja e njoftimit, është i

detyruar t' i ndreqë ato.

Neni 25 **Llojet e kontrollit**

1. Kontrolli i deklarimeve përfshin kontrollet, aritmetik e logjik, dhe verifikimin e miratimit të dhënave të deklaratës (kontroll i plotë).

Kontrollet, aritmetik dhe logjik, kryhen për çdo deklaram për të vërtetuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruara dhe mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet e deklaruara.

Verifikimi e miratimi i të dhënave të deklaratës (kontroll i plotë) bëhen për ato deklarime, të cilat, nga kontrollet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, paraqesin probleme, papajtueshmëri dhe parregullsi në justifikimin e burimeve të mbulimit të pasurisë ose në pasurinë e deklaruar dhe në deklarime të tjera, sipas skemës së kontrollit.

Në kuptim të këtij ligji, janë parregullsi në justifikimin e burimeve rastet kur burimet dhe pasuritë e krijuara nuk përputhen për shumën mbi 1 000 000 lekë për deklaramet vjetore dhe për shumën mbi 2 000 000 lekë për deklaramet e bëra sipas neneve 6 dhe 9 të këtij ligji.

Skema e kontrollit të deklarameve duhet të përfshijë kontrollin e plotë të deklaratave, jo më pak se një herë në dy vjet.

2. Verifikimi dhe kontrolli i pasurisë, i detyrimeve financiare kryhet i plotë, për çdo vit, për Presidentin e Republikës, Kryetarin e Kuvendit, Kryeministrin, Zëvendëskryeministrin, ministrat dhe drejtuesit, funksionet e të cilëve barazohen me ta.

3. Metodikat dhe manualët e ushtrimit të kontrollit miratohen nga Inspektori i Përgjithshëm.

Neni 26 **Detyrimi për të dhënat**

Për kryerjen e kontrollit dhe verifikimin e të dhënave të deklaratës, Inspektorati i Lartë dhe ai i ulët kanë të drejtë të shfrytëzojnë të dhënat e nevojshme në të gjithë aparatit shtetëror e publik dhe në personat juridikë publikë e privatë.

Me kërkesë të Inspektorit të Përgjithshëm bankat e nivelit të dytë dhe subjektet e tjera, që ushtrojnë veprimtari bankare dhe financiare në Republikën e Shqipërisë, detyrohen të japin të dhëna për depozitat, llogaritë dhe transaksionet e kryera nga personat që, sipas këtij ligji, kanë detyrimin për deklaram.

Subjektet e mësipërme janë të detyruara të vënë në dispozicion të gjitha të dhënat e kërkuara brenda 15 ditëve nga paraqitja e kërkesës me shkrim nga Inspektori i Përgjithshëm.

Neni 27 **Korrigjimi i gabimeve në deklaram**

Kur gjatë kontrollit zbulohet se deklaramet nuk janë të sakta ose burimet e deklaruara nuk identifikohen dhe nuk mbulojnë pasuritë e deklaruara, Inspektorati i Lartë ose ai i ulët thërret subjektin për të dhënë shpjegime të hollësishme dhe argumentet përkatëse, të cilat paraqiten kurdoherë me shkrim.

Neni 28 **Pasuritë e fituara në mënyrë të paligjshme**

Kur edhe nga procedurat e përcaktuara në nenin 27 nuk mund të justifikohen me burime të ligjshme pasuritë e krijuara dhe kur këto mospërputhje janë mbi 2 000 000 lekë për deklaramet vjetore dhe mbi 3 000 000 lekë për deklaramet sipas neneve 6 dhe 9 të këtij ligji, atëherë vlerësohet se pasuritë janë krijuar në mënyrë të paligjshme dhe Inspektori i Përgjithshëm njofton menjëherë prokurorinë.

Neni 29
Thirrja e ekspertëve

Inspektori i Përgjithshëm ose kryetari i inspektoratit të ulët kanë të drejtë të thërrasin ekspertë të pavarur, të licencuar, të fushave të ndryshme, për të bërë rivlerësimin e pasurive ose për çështje që këta çmojnë të arsyeshme.

Ekspertët janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin e të dhënave që sigurojnë gjatë ekspertimit dhe mbajnë përgjegjësi, sipas dispozitave të Kodit Penal, për ekspertim të rremë. Shpenzimet e ekspertëve përballohen nga buxheti i Inspektoratit të Lartë ose nga ministria apo institucioni, në varësi të të cilit është inspektorati i ulët që ka kërkuar ekspertimin.

Neni 30
Dokumentimi i kontrollit

Për çdo deklaratë që i nënshtrohet kontrollit të Inspektoratit të Lartë ose të inspektorateve të ulëta plotësohet fleta e kontrollit, sipas mënyrës së përcaktuar nga Inspektori i Përgjithshëm, e cila nënshkruhet nga inspektori që ka ushtruar kontrollin.

Neni 31
Përmbajtja e të dhënave

Në bazë të fletëkontrolleve hartohen të dhënat, respektivisht për Inspektorin e Përgjithshëm ose për ministrin apo drejtuesin e institucionit qendror.

Të dhënat duhet të përmbajnë, në mënyrë të përmbledhur, identifikimin e deklaratave, që i janë nënshtruar kontrollit, faktet dhe parregullsitë e gjetura, si dhe propozimet për masa disiplinore e gjoba për kundërvajtjet dhe, kur është rasti, propozimet për kallëzime për ndjekje penale.

Neni 32
Pasuritë e fituara nga fshehja e detyrimeve fiskale

Kur pasuritë e fituara gjykohen se janë rrjedhojë e fshehjes së detyrimeve fiskale, Inspektori i Përgjithshëm ose inspektorati i ulët njofton organet tatimore.

Neni 33
Ruajtja e dokumenteve

I gjithë dokumentacioni, që ka të bëjë me deklarimin dhe kontrollin e pasurive, arkivohet sipas rregullave dhe ruhet për një periudhë 10-vjeçare. Ky detyrim përfshin edhe dokumentacionin e deklarimit të pasurive, i cili u përket periudhave të mëparshme e që është gjendje në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 34
Publikimi

Të dhënat që përfitohen nga deklarimi sipas këtij ligji janë të lejueshme për publikun, në përputhje me ligjin nr.8503, datë 30.6.1999 "Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare".

Neni 35
Mbikëqyrja e inspektoratit të ulët

Inspektorati i Lartë është i detyruar të kontrollojë punën e inspektoratit të ulët jo më pak se një herë në dy vjet, sipas rregullave të caktuara nga Inspektori i Përgjithshëm.

Neni 36

Ndreqja e parregullsive

Kur Inspektorati i Lartë, gjatë kontrollit të punës së inspektoratit të ulët, vëren shkelje ose parregullsi, i ndreq vetë parregullsitë e vërtetuara ose i kërkon inspektoratit të ulët ndreqjen e tyre brenda 10 ditëve.

Neni 37

Masat disiplinore

Inspektori i Përgjithshëm, për shkeljen e kryer nga anëtarët e inspektoratit të ulët, i propozon titullarit largimin nga funksioni të anëtarit të inspektoratit të ulët.

Neni 38

Deklarimi i rremë

Deklaratat dhe të gjitha dokumentet që i shoqërojnë ato janë dokumente zyrtare. Paraqitja në to e të dhënave të rreme përbën vepër penale dhe dënohet sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 39

Raportimi

1. Inspektori i Përgjithshëm i raporton Kuvendit, jo më vonë se më 31 maj të çdo viti, për veprimtarinë e kryer në vitin pararendës, si dhe sa herë që thirret nga Kuvendi.

Inspektori i Përgjithshëm mund t'i kërkojë Kuvendit ta dëgjojë për çështje që ai i çmon të rëndësishme.

2. Çdo vit inspektorati i ulët i paraqet Inspektoratit të Lartë një raport për veprimtarinë e kryer në vitin pararendës, jo më vonë se data 31 janar e çdo viti.

KREU IV

KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

Neni 40

Në kuptim të këtij ligji, kur veprimi ose mosveprimi nuk përbën vepër penale, përbën kundërvajtje administrative dhe kundërvajtësit dënohen si më poshtë:

a) kur deklaratat dhe dokumentet shoqëruese nuk paraqiten në afatin e caktuar, pa shkaqe të arsyeshme, subjekti që mbart detyrimin për deklarim gjobitet me 25 000 lekë.

Në qoftë se edhe pas 15 ditëve të komunikimit të gjobës subjektet e përcaktuara në nenet 3 dhe 7 vazhdojnë të mos deklarojnë, gjoba dyfishohet. Në këtë rast njoftohen menjëherë organet përkatëse;

b) për mosngritjen e inspektoratit të ulët, sipas nenit 18 të këtij ligji, titullari i subjektit gjobitet me 50 000 lekë;

c) kur kryetari i inspektoratit të ulët nuk dërgon në afat në Inspektoratin e Lartë të dhënat për deklarimin, ai gjobitet me 20 000 lekë;

ç) kur nuk jepen të dhënat e kërkuara sipas nenit 26 të këtij ligji, subjektet gjobiten me 50 000 lekë;

d) kur ekspertët refuzojnë kryerjen e ekspertimit ose kur ata nuk paraqiten, pa shkaqe të arsyeshme, për kryerjen e ekspertimit, sipas nenit 29 të këtij ligji, gjobiten me 100 000 lekë;

dh) kur, pa shkaqe të arsyeshme, organet e ngarkuara për këtë qëllim nuk ekzekutojnë gjobat, sipas nenit 41 të këtij ligji, ato gjobiten me 50 000 lekë.

Të drejtën e këtyre gjobave e ka Inspektori i Përgjithshëm, me propozimin e personelit të Inspektoratit të Lartë. Ndërsa kryetari i inspektoratit të ulët ka të drejtën e gjobave vetëm për shkronjat "a", "d" e "dh" të këtij neni, kryesisht ose me propozimin e anëtarëve të inspektoratit të ulët.

Kundër vendimit të gjobës së vënë nga Inspektori i Përgjithshëm mund të bëhet ankim në gjykatën e rrethit brenda 30 ditëve nga dita e marrjes së njoftimit, ndërsa për vendimet e gjobës së vënë nga inspektorati i ulët mund të bëhet ankim tek Inspektori i Përgjithshëm brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit dhe më pas, brenda 30 ditëve nga marrja e këtij vendimi, mund të bëhet ankim në gjykatë.

Neni 41

Ekzekutimi i gjobave

Gjobat paguhen nga kundërvajtësi dhe derdhen në buxhet jo më vonë se 30 ditë nga komunikimi i gjobës.

Me kalimin e këtij afati, vendimi i dhënë shndërrohet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga punëdhënësi, kur kundërvajtësi është në marrëdhënie pune, ose nga zyra e përmbarimit, me kërkesën e Inspektorit të Përgjithshëm ose të kryetarit të inspektoratit të ulët.

KREU V

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 42

Ligji nr.7903, datë 8.3.1995 "Për deklarimin e pasurive të të zgjedhurve dhe të disa drejtuesve e punonjësve të shërbimit publik" dhe çdo dispozitë tjetër, që vjen në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 43

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekret nr.3805, datë 5.5.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

L I G J

Nr.9053, datë 17.4.2003

PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR.7973, DATË 26.7.1995 "PËR KONCESIONET DHE PJESËMARRJEN E SEKTORIT PRIVAT NË SHËRBIMET PUBLIKE DHE INFRASTRUKTURË", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.7973, datë 26.7.1995 "Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë", i ndryshuar, bëhen shtesat si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 3, pas pikës 9 shtohet pika 10 me këtë përmbajtje:
"10. Mjediset sportive".

Neni 2

Në rreshtin e dytë të paragrafit të parë të nenit 4, pas pikave 2, 3, 4, 7, 8 dhe 9 shtohet dhe pika 10.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekret nr.3796, datë 24.4.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;

- pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:

Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

Kodi Penal <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Mars, 2002	Kodi i Procedurës Penale <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Shtator, 2002	Kodi i Procedurës Civile <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Korrik, 2002	Kodi Rrugor <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Qershor, 2002
Kodi Penal Ushtarak <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Tetor, 2002	Përmbledhëse legjislacioni në fushën e Përmbardimit <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Tetor, 2002		

U dorëzua për shtyp më 15.5.2003

Doli nga shtypi më 15.5.2003

Tirazhi: 4300 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2003

Çmimi: 150 lekë